



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:908921

Datë: 25.01.2021

Numri i dokumentit: 01436947

**Ac.nr.4353/2018**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Kujtim Pasuli kryetar i kolegjit dhe Nenad Llaziq e Milena Gjeriq anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.S. nga fshati ... Komuna e Parteshit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.Q. nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Parteshit, të cilën e përfaqëson me autorizim av. RR.L., nga Gjilani, për shkak të pagesës të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit , të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.453/2014, të datës 12.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.01.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit J.S. nga fshati ..., Komuna e Parteshit, av. E.Q. nga Gjilani, **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.453/2014, të datës 12.07.2018.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e goditur nën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpapia e J.S. nga fshati ..., ndaj të paditurës Komuna e Parteshit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Partesh, për kompensimin e të ardhurave personale – pagave mujore, për 7 muaj, nga 200,10 €, të llogaritura në lartësi prej 1.407,70 €. Nën II të dispozitivit është detyruar paditësi J.S., t'ia paguaj të paditurës Komuna e Parteshit, sipas Rregullores së T.A të Republikës së Kosovës, shpenzimet e procedurës kontestimore, për pesë seanca të përfaqësimit , nga 135.20 €, të gjitha të llogaritura prej 766,00 €, dhe në emër të ushtrimit të përgjigjes në padi shumën prej 104 €, të gjitha të llogaritura në lartësi prej 870,00 €, këtë në afat prej 7 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me vërejtje të përmbarimit të detyruar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i paditësit av. E.Q., nga Gjilani, për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore,
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, të aprovojë ankesën si të bazuar, ashtu që aktgjykimi i goditur të ndryshohet duke

aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrohet e paditura që t'ia paguaj paditësit kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve gjatë kohës sa në mënyrë të paligjshme nuk ia ka paguar të ardhurat personale sipas kontratës së punës në fuqi për 7 muaj nga 200,10 €, gjithsejtë shumën prej 1.400,70 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore gjithsejtë shumën prej 1.644 € ose të priset dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditurës av. RR.L., nga Gjilani, me propozim që të refuzohet ankesa e paditësit si e pabazuar, kurse aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194 të Ligjit të procedurës kontestimore, ka vlerësuar aktgjykimin e goditur në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 2 pika b), g), j), k) dhe m) dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi nëpërmjet të autorizuarit av. E.Q. nga Gjilani, ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj të ardhurat personale – pagat mujore për 7 muaj nga 200,10 €, gjithsejtë shumën prej 1.400,70 €, e që nuk janë paguar sipas kontratës së punës në fuqi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave, ka marr vendimin më afër të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur, duke gjetur se paditësi ka falsifikuar kontratën e punës kinse ishte punëtor te e paditura, përkatësisht në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në fshatin Pasijan për periudhën 2013 -2014, i sistemuar si punëtor ndihmës apo pastrues, pasi kontrata e tij nuk përputhej me numrin e protokollit, emrin dhe kohën, për çka në librin e protokollit është shënuar dhënia e vërtetimit në emër të G.T., nga fshati Partesh. Njëherit shërbimi arsimor i Komunës së Parteshit dhe Inspektorati arsimor rajonal në Gjilan, kanë raportuar se në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Parteshit gjenden 134 persona që nuk kanë punuar dhe kanë realizuar paga mujore deri në muajin janar të vitit 2014, e në mesin e tyre ka qenë edhe paditësi. Për ndryshe gjykata e shkallës së parë ka gjetur se paditësi nuk është i regjistruar si punëtor ndihmës apo pastrues te e paditura dhe nuk punon në ndonjërin nga shkollat e Komunës së Parteshit, gjithashtu edhe dëshmitarët kanë vërtetuar faktin se paditësi nuk kishte themeluar marrëdhënie pune sipas sistemit arsimor të Republikës së Kosovës, ndërsa paditësi realizonte paga mujore nga buxheti i Republikës së Serbisë. Përfundimisht gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në faktin se paditësi me asnjë provë nuk ka mundur ta vërtetoj bazueshmërinë e kërkesëpadiës, ka vendosur që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, bazuar në dispozitën e neneve 143 , 149 dhe 388 të LPK-së. Sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës kontestimore vendimin e vet e bazon në dispozitën e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar aktgjykimin e goditur të gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 194 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika b),g),j),k) dhe m), në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilën thirret ankesa nga neni 182 par. 2 pika n) të LPK-së. Kjo për arsye se aktgjykimi i goditur është i qartë nuk ka të meta për shkak

të cilave nuk mund të ekzaminohet, nuk është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e dhëna si dhe në të janë treguar arsyet për faktet vendimtare për marrjen e një vendimi të drejtë e të ligjshëm.

Pretendimet ankimore në drejtim të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike janë të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se paditësi nuk ka pasur kontratën e vlefshme të punës, nga data 01.09.2013, e deri më dt. 31.08.2014, e kjo aq më tepër kur paditësi nuk ka mundur t'ia prezantoj gjykatës kontratën origjinale e të kërkuar, ndërsa nga ana tjetër në kuptim të dispozitës së nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa nga ana tjetër e paditura ka theksuar se një kontratë e tillë nuk ekziston dhe në këtë drejtim edhe ka bashkangjitur protokollin, përkatësisht librin e protokollit ku nuk figuron kontrata me paditësin, por dhënia e vërtetimit në emër të personit tjetër dhe atë G.T. nga fshati .... Njëherit gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike bazuar edhe në të gjeturat e Ministrisë së Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Zyra e sekretarit të përgjithshëm – Departamenti i Inspeksionit të Arsimit (DIA) MASHT-Prishtinë me numër Ref.10/1-3 Nr. protokollit 120/14 i datës 02.06.2014, gjatë verifikimit të regjistrave të pagave në shkollat ku është edhe shkolla e mesme e mjekësisë në ..., Komuna e Parteshit si dhe nga raporti për arsimim i datës 11.02.2014, ku është vërtetuar se 134 persona marrin paga pa punuar fare në mesin e të cilëve është edhe këtu paditësi. Njëherit një vërtetim i tillë i gjendjes faktike rezulton edhe nga deponimi i dëshmitares V.J. nga fshati Partesh, për ndryshe Drejtoresh nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Parteshit, e cila ka vërejtur se 100 punëtor nuk punojnë dhe realizojnë të ardhura personal nga buxheti i Kosovës, e në mesin e tyre ka qenë edhe paditësi, i cili nuk ka kontratë valide, pasi që kontrata e prezantuar në fotokopje nuk është protokolluar në librat e protokollit. Përndryshe ajo ka sqaruar se Inspektorati i Arsimit, ka ardhur në Komunë dhe ka gjetur se janë 134 persona që marrin paga pa punuar fare në mesin e të cilëve edhe këtu paditësi, dhe të njëjtëve i është ndërprerë realizimi i të ardhurave personale nga buxheti i Republikës së Kosovës. Prandaj nga të cekurat rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe pretendimet ankimore paraqiten si të pa bazuara

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë pran gjendjes faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit kundër të paditurës për kompensimin e të ardhurave personale – pagave për 7 muaj, në lartësi prej 1.407,70 €, si dhe drejtë ka detyruar paditësin që të paditurit t'ia kompensoj edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 870 €.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerësoj edhe pretendimet e tjera ankimore, dhe gjet se nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo të cilën e ka marr gjykata e shkallës së parë.

Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.4353/2018, të datës 19.01.2021**

**Kryetari i kolegjit**  
**Kujtim Pasuli**